

DEKLARATA E UIAA-SË PËR ECJE MALORE, NGJITJE NË SHKËMBINJË DHE ALPINI- ZEM

UIAA konsideron se parimet e përcaktuara në këtë Deklaratë janë normat bazë që të gjithë ecësit, alpinistët dhe ngjitësit duhet t'i ndjekin:

ETIKA DHE STILI

- Ne shpallim me ndershmëri stilin tonë të ngjitjes
- Ne pranojmë stilet e të tjerëve, edhe kur ato ndryshojnë nga i yni
- Ne nuk do të dëmtojmë përvojën e të tjerëve gjatë ecjes apo ngjitjes

BALANCIMI I RREZIKUT, SUKSESIT DHE DËSHTIMIT

- Ne marrim parasysh ndikimin mbi të tjerët para se të marrim rreziqe
- Ne ndihmojmë të tjerët kur kanë nevojë, edhe nëse kjo dëmton qëllimet tona

TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Ne respektojmë ekosistemet natyrore në zonat e ngjitjes dhe rajonet malore
- Ne e njohim ndryshimin klimatik dhe përpiqemi të ulim ndikimin tonë
- Ne i përmbahemi rregulloreve lokale dhe respektojmë komunitetet dhe kulturat lokale
- Ne mbrojmë një qasje të përgjegjshme në hapësirat natyrore



International Climbing and Mountaineering Federation
UNION INTERNATIONALE DES ASSOCIATIONS D'ALPINISME

